

VENDIM
Nr. 693, datë 22.10.2014

PËR KRIJIMIN E QENDRËS SË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTEGRUARA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, dhe të neneve 10 e 11, të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Qendrës së Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara, si institucion juridik publik, në varësi të ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, me seli në Tiranë.

2. Qendra e Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara (*Albanian Delivery Integrated Services Agency*), në vazhdim ADISA, ka si mision të veprimtarisë:

a) ofrimin e shërbimeve publike nëpërmjet ngritjes dhe administrimit të qendrave të shërbimeve publike të integruara me një ndalesë (*one-stop-shop*);

b) aplikimin e modelit të ri të ofritit të integruar të shërbimeve publike me qytetarin në qendër.

3. Qendra e Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara ka këto funksione administrative dhe përgjegjësi specifike:

a) Lëvron shërbimet në sportele të integruara për qytetarët, nëpërmjet marrëveshjeve apo koordinimit të proceseve me institucionet përgjegjëse;

b) Aplikon instrumente të ndryshme monitoruese për të siguruar cilësinë e lëvrimin të shërbimeve ndaj qytetarit;

c) Merr pjesë në hartimin e procedurave dhe standardeve për sportelet pritëse të qytetarëve (*front office*) dhe zyrave mbështetëse (*back office*), përgjegjëse për përpunimin e të dhënave dhe finalizimin e shërbimeve publike në qendrat e shërbimeve publike të integruara me një ndalesë;

ç) Zhvillon trajnime të vazhdueshme në përputhje me standardet e përcaktuara në shkronjën “c”.

4. ADISA organizohet dhe funksionon në nivel qendror nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Qendrës së Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara dhe në nivel vendor nëpërmjet qendrave të shërbimeve publike të integruara me një ndalesë. Struktura e kësaj qendre miratohet nga Kryeministri.

5. ADISA financohet nga buxheti i shtetit dhe nga burime të tjera, të ligjshme.

6. ADISA drejtohet nga drejtori i Përgjithshëm, i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e kësaj qendre dhe raporton para ministrit përgjegjës për inovacionin dhe administratën publike.

7. Drejtori i Përgjithshëm i ADISA-s emërohet, lirohet ose shkarkohet me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit përgjegjës për inovacionin dhe administratën publike.

8. Përjashtimisht për vitin 2014, ADISA-s i shtohen 3 (tre) punonjës. Ky numër përballohet nga numri rezervë i Këshillit të Ministrave.

9. Në grupin e institucioneve të tjera qeveritare (Gr. 87) në programin “Shërbime të tjera”, shtohet fondi prej 700 000 (shtatëqind mijë) lekësh në zërin “Shpenzime korrente” për ADISA-n, për vitin 2014.

10. Në buxhetin e miratuar për vitin 2014, për Kryeministrinë, pakësohet fondi prej 700 000 (shtatëqind mijë) lekësh, në zërin “Shpenzime korrente”, në programin “Planifikim, menaxhim dhe administrim”.

11. Ngarkohen Kryeministria, ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama